



Në mbledhjen e parë, Këshilli Kombëtar i Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Sistemit Shëndetësor të Shqipërisë (S.P.P.S.SH.SH) miratoi ngritjen e grupeve të punës në funksion të organizimit të sindikatës dhe marrjen e masave për organizimin e konferencave zgjedhore në përputhje me statutin. Gjithashtu miratoi grupet e punës për ngritjen e rrjetit rinor, të gruas, dhe të pensionistëve (ish bluzat e bardha) dhe komisionin e kontroll- revizionit dhe verifikimit të mandateve. Me propozim të Presidentit të Sindikatës së Pavarur të Punonjësve të Sistemit Shëndetësor të Shqipërisë z. Dritan Korumi u miratua kandidatura e z. Gjovalin Markvukaj për Zv/ President të dytë të S.P.P.S.SH.SH.

